

DHOMA E TREGTISE DHE INDUSTRISE  
DURRES



**STATUTI**

*Miratuar nga Asamblea, me Vendim nr. 1, date 10 Mars 2007  
Hyre ne fuqi me date 10 Prill 2007*



## HYRJE

Me miratimin e ketij Statuti hapet rruga e riorganizimit te Dhomes se Tregtise dhe Industrise se Qarkut Durres si dhe e funksionimit te saj, sipas orientimeve dhe percaktimeve te ligjit Nr. 9640, date 9.11.2006, "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise".

Dhoma e sotme e Durresit, pasardhese e shume te njohures "Oda e Tregtise", krijuar me 1921, ka kryer deri tani ato detyra, te cilat historikisht i atribuohen Dhomave te Tregtise kudo ne bote. Me riformulimin e ketij dokumenti themelor te saj, Dhoma merr funksione te tjera, qe e bejne ate nje nga institucionet me te rendesishme per mbeshtetjen e zhvillimit te sistemit te ndermarrjeve private dhe te ekonomise ne rajonin e Durresit dhe ate te Krujes

Ky Statut thekson ne menyre te vecante vleresimin dhe respektin e Dhomes per shoqatat e biznesit, te cilat mbeshtesin interesat e vecanta te kategorise, duke qene plotesuese te njera tjetres, me mbeshtetjen e interesave te pergjitheshme te biznesit nga Dhoma.

Nderkaq, Statuti thekson parimet baze te nje ekonomie te hapur tregu, qe frymezojne veprimtarine e Dhomes, si nisiativa e lire ekonomike, konkurenca e lire dhe e ndershme, apo shanset e njejta per rritje, si per sipermarresit, ashtu dhe per te punesuarit.

Per here te pare, me ane te ketij Statuti, Dhoma u garanton te gjitha antareve te saj krijimin e organeve drejtuese me kompetenca jo vetem te qarta, por edhe te ballancuara.

Krahas formave te shumllojshme te mbeshtetjes se biznesit, Statuti nenvizon detyren e Dhomes per te pasur "zerin" e saj, per te artikuluar dhe shprehur propozimet e saj ndaj pushtetit vendor apo qendror, si per zgjidhjen e ceshtjeve problematike, ashtu dhe per zhvillimin dhe rritjen e biznesit dhe te ekonomise ne territorin e saj te kompetences.

Keshtu, shpresojme qe me kete dokument themelor te saj, Dhoma te kete dhene kontributin e saj jo vetem ne favor te zhvillimit ekonomik, por edhe te permiresimit te cilesise se raporteve institucionale, shoqerore dhe qytetare, brenda teresise se komunitetit operues ne Qarkun Durres.

Kryetari

Andrea XHAVARA



## **KREU I. DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

### **Neni 1**

#### **Natyra dhe qellimet**

1. Dhoma e Tregtise dhe Industrise se Qarkut Durres, e cila ne vazhdim emertohet thjesht "Dhoma", e krijuar ne zbatim te ligjit Nr. 9640, date 9.11.2006, "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise", eshte person juridik, qe ushtron veprimtarine e saj ne mbeshtetje te interesave te pergjitheshme te sistemit te sipermarrjeve operuese ne Qarkun Durres.
2. Dhoma, ne permbushjen e detyrave institucionale te saj, promovon zhvillimin e sistemit te sipermarrjeve, qe i perkasin sektoreve te Industrise, te Bujqesise, te Tregtise dhe te Sherbimeve, duke vleresuar dhe respektuar njekohesisht pavaresine dhe veprimtarine e shoqatave profesionale te biznesit, te sindikatave, te konsumatoreve , si dhe te organizatave te tjera shoqerore.
3. Dhoma frymezohet ne veprimtarine e saj nga parimet e inisiatives se lire ekonomike, te konkurences se lire, si dhe te respektit dhe mbrojtjes se dinjitetit te punes. Dhoma mbeshtet nje ekonomi te hapur, e cila garanton mundesi te barabarta rritjeje, si per sipermarresit ashtu dhe per te punesuarit prej tyre.
4. Dhoma gezon pavaresi statutore, funksionale, organizative dhe financiare, pervec kufizimeve, qe percaktohen shprehimisht nga ligji Nr. 9640, date 9.11.2006, "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise".
5. Dhoma nuk ushtron veprimtari fitimpruese. Cdo teprice vjetore e te ardhurave mbi shpenzimet mund te perdoret vetem per realizimn e veprimtarise se saj.

### **Neni 2**

#### **Funksionet e Dhomes**

Dhoma ushtron funksionet e meposhteme:

- ✓ Ndermerr cdo veprimtari, qe i sherben nxitjes dhe mbrojtjes se biznesit
- ✓ Jep mendime, propozime dhe vleresime per nismat ligjore apo politikat publike, te ndermarra nga administrata qendrore, vendore dhe subjektet e tjera publike, permbajtja e te cilave prek interesat e antareve te saj. Shprehja e opinioneneve behet si ne rastet nga kur nga



administrata publike kerkohet nje gje e tille, ashtu dhe ne menyre te pavarur, pa ndonje kerkese paraprake.

- ✓ Organizon apo merr pjese ne panaire dhe ekspozita me karakter vendor, kombetar dhe nderkombetar.
- ✓ Mban Rregjistrin e antarsise se saj, duke bazuar ne te sherbime individuale dhe promovim per antaret e Dhomes, si dhe informacion per publikun.
- ✓ Ofron per antaret e saj asistence teknike (trajnime, seminare, konsulence), si dhe informacion me interes per biznesin.
- ✓ Leshon certifikatat e origjines per eksportet, ne kompetence ligjore te saj.
- ✓ Mbeshtet autoritetet shteterore me informacion, me qellim parandalimin e konkurrences se pandershme.
- ✓ Ndhmon antaret e Dhomes per zgjidhjen e mosmarreshjeve tregtare apo civile me ane te rruges se ndermjetesimit, duke krijuar vete edhe komisione keshillimi, pajtimi apo arbitrazhi.
- ✓ Kryen cdo funksion tjeter, qe i eshte deleguar me ligj apo vendim te posacem te autoriteteve shteterore.

### **Neni 3**

#### **Selia, zyrat e tjera ne territor**

- Dhoma e ka seline ne qytetin Durres, qendra e Qarkut Durres, ne adresen Rr. Skenderbej, "Crystal Tower". Vendndodhja e selise se Dhomes mund te ndryshoje me vendim te organeve drejtuese te saj.
- Me qellim decentralizimin e sherbimeve, Dhoma ngre 1 (nje) Zyre te vecante ne qytetin e Krujes, menyra e funksionimit dhe detyrat e se ciles percaktohen me vendim te vecante te Kryesise. Staf i zyres se perfaqesimit Kruje eshte pjese e struktures organizative te Dhomes dhe per punonjesit e saj zbatohen te njejtat kriteret si per punonjesit e Dhomes.

### **Neni 4**

#### **Logo dhe vula**

- Logo e Dhomes paraqet nje anije liburne me vela, e rrethuar me dy kapitete te stilizuara, me diellin me dy ngjyra, dy gjysmat e te cilit simbolizojne pozicionin e qytetit te Durresit ne



Ballkan, si porte e Lindjes dhe e Perendimit njeheresh. Logo perdoret detyrimisht ne te gjitha shkresat zyrtare te Dhomes. Shenimet per institucionin jane: ne shqip, *Dhoma e Tregtise dhe Industrise Durres-Shqiperi*, ndersa ne anglisht, *Durres Chamber of Commerce and Industry-Albania*.

- Vula e Dhomes ka forme rrethore me diameter 4 (kater) centimetra, brenda se ciles jane shkruar ne forme rrethore shenimet: Republika e Shqiperise, Dhoma e Tregtise dhe Industrise Durres, si dhe, i stampuar, simboli i shqipes dykrenare.

## **Neni 5**

### **Parimet e veprimtarise administrative te Dhomes**

- Dhoma i ushtron funksionet e saj duke bashkepunuar me Administraten Publike, qendrore apo vendore, si dhe me institucionet e tjera vendase, publike apo private, duke e bazuar kete bashkepunim ne parimet e paanshmerise, te efektivitetit dhe te eficences, si dhe te transparences.
- Dhoma promovon bashkepunimin me institucionet publike e private edhe ne nivel nderkombetar , kur ato jane te predispozuara ose te interesuara per zhvillimin ekonomik te territorit te saj te kompetences, si dhe per integrimin me ekonomine rajonale, europiane, apo globale.
- Me qellim promovimin dhe integrimin e saj, Dhoma mund te antarsohet ne organizatat nderkombetare te dhomave te tregtise, mund te nenshkruaje marreveshje, te krijojte partneritete dhe te realizoje projekte te perbashketa me dhoma apo institucione te tjera te huaja.

## **Neni 6**

### **Dhoma dhe Bashkimi i Dhomave**

- Dhoma eshte antare e Bashkimit te Dhomave te Tregtise dhe Industrise se Shqiperise.
- Dhoma paguan kuoten vjetore te antarsise ne Bashkimin e Dhomave, e cila caktohet nga Asambleja e Bahkimit te Dhomave, ne perpjestim me numrin e antareve te rregjistruar ne Dhome.
- Dhoma perfaqesohet ne Asamblene e Bashkimit te Dhomave, me nje numer antaresh ne perpjestim te drejte me numrin e antareve te rregjistruar ne Dhome.



- Dhoma merr pjese ne te gjitha nismat e Bashkimit te Dhomave, qe kane per synim mbeshtetjen, zhvillimin dhe promovimin e biznesit shqiptar.
- Dhoma ben pjese ne rrjetin informativ kombetar te Dhomave, te koordinuar nga Bashkimi i Dhomave.

## **KREU II. ORGANIZIMI I DHOMES**

### **Neni 7**

#### **Organet drejtuese dhe kontrolluese**

Organet drejtuese dhe kontrolluese te Dhomes jane:

1. Asamblea
2. Kryesia
3. Kryetari
4. Sekretari i Dhomes
5. Komisioni i Auditimit

### **Neni 8**

#### **Asamblea**

- Asamblea është organi më i lartë vendimmarrës i Dhomës. Ajo zgjidhet nga tërësia e anëtarëve të Dhomës. Numri i antareve te Asamblese se Dhomes eshte jo me i vogel se 21 dhe jo me i madh se 101.
- Zgjedhjet per Asamblene e Dhomes zhvillohen ne 3(tre) grupe te vecanta:
  1. Tregti
  2. Industri
  3. Sherbime

Asamblea e Dhomës siguron përfaqësimin ne te, te çdo grupi veprimtarie ekonomike, në atë përqindje që zë çdo grup kundrejt numrit të përgjithshëm të anëtarësisë në Dhomë.

- Anëtarët e Asamblesë janë persona, që kanë zotësi të plotë për të vepruar, gëzojnë reputacion në komunitetin e biznesit të grupit, që ata përfaqësojnë dhe qe nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale.
- Anëtarët e Asamblesë duhet të jenë të autorizuar nga subjekti tregtar, që përfaqësojnë, për të ushtruar të drejtën e votës. Çdo subjekt tregtar ka të drejtë të përfaqësohet në Asamblenë e Dhomës vetëm me një anëtar.



## **Neni 9**

### **Kompetencat e Asamblese**

Asambleja percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se Dhomes, kontrollon zbatimin e tyre, miraton aktet themelore, ne kompetence te saj, si dhe ushtron funksione te tjera, qe i ngarkohen asaj sipas ketij Statuti.

Asambleja ka ne vecanti keto kompetenca:

1. Shqyrton dhe percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se Dhomës.
2. Miraton statutin dhe ndryshimet e tij dhe ia dergon ato per miratim organit mbikqyres.
3. Zgjedh nga anetarët, me votime te fshehta e te veçanta, Kryesinë, Kryetarin, Komisionin e Auditimit dhe perfaqesuesit e Dhomës ne Asamblenë e Bashkimit te Dhomave.
4. Percakton shperblimet per Kryetarin e Dhomës dhe per antaret e Komisionit te Auditimit.
5. Miraton programin dhe buxhetin e vitit pasardhes
6. Shqyrton e miraton raportin vjetor te veprimtarive ne pergjithësi dhe te veprimtarise financiare te Dhomës.
7. Miraton masen e kuotizacionit vjetor te anetarëve.
8. Miraton akte te ndryshme per funksionimin dhe organizimin e Dhomës.

## **Neni 10**

### **Te drejtat e antarit te Asamblese**

Antari i Asamblese ka te drejte:

- Te ushtroje inisiative per zbatimin e vendimeve ne kompetence te Asamblese
- Te paraqese pyetje, interpelanca dhe mocione.
- Te nderhyje(marre pjese) ne diskutimet e Asamblese
- Te marre, nga Sekretari dhe nga drejtues te departamenteve te Dhomes, kopie te akteve, dokumentave dhe informacioneve, qe jane te vlefshem dhe kane lidhje me ushtrimin e mandatit te tij.
- Te perfaqesoje Dhomen, kur ka marre nje mandat te tille nga Asambleja, Kryesia apo Kryetari.

Anetari i Asamblese e humbet mandatin kur:

- Shkel dispozitat e ketij ligji dhe te ligjeve te tjera ne fuqi, si dhe statutin e Dhomes,
- Ne se brenda dt. 31 Mars te vitit ne vazhdim, subjekti, te cilin ai perfaqeson, nuk ka paguar kuoten vjetore te anetaresise
- Subjekti te cilin perfaqeson, nuk egziston me per shkak falimentimi apo mbyllje te



aktivitetit me vendim gjykate.

- Nuk merr pjese, pa pasur nje motiv te justifikueshem, ne tre mbledhje te zakonshme te njepasnjeshme te Asamblese
- Kur jep doreheqjen
- Eshte ne pamundesi per te ushtruar mandatin e tij (arsye shendetsore, personale etj),
- Denohet nga gjykata me vendim te formes se prere per kryerjen e nje vepre penale.
- Ne rastin e largimit te nje anetari te Asamblese, vendin e tij e ze personi i renditur me me shume pike ne listen perfundimtare te votimit te grupit perkates te biznesit ( pas anetareve te Asamblese se ketij grupi). Kur mbaron lista e kandidaturave te mundshme, atehere Asamblea vendos te behen zgjedhje te pjeseshme per ate grup biznesi, me qellim plotesimin e vendeve ne Asamble.
- Mandati i anetarit te ri zgjat deri ne perfundim te mandatit te Asamblese.

### **Neni 11**

#### **Detyrat e antarit te Asamblese**

- Antari i Asamblese e ushtron mandatin e tij duke respektuar kriteret e etikes dhe paanshmerise. Ai eshte i detyruar te abstenoje nga votimi, duke u larguar nga salla e mbledhjes, ne rastin kur vendoset per ceshtje, qe kane lidhje me interesat e subjektit, qe ai perfaqeson
- Mandati i antarit te Asamblese eshte i papajtueshem me detyren e nepunesit te Dhomes.

### **Neni 12**

#### **Funksionimi i Asamblese**

- Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të saj. Ne mbledhjet e Asamblese nuk lejohet delegimi ne pjesemarrje dhe ne votim. Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Dhomes.
- Vendimet e Asamblese konsiderohen te vlefshme, kur ato votohen nga shumica absolute e antareve te pranishem, me perjashtim te ceshtjeve te lidhura me Statutin.
- Statuti dhe ndryshimet e tij miratohen me shumicen absolute te numrit te pergjithshem te anetareve te Asamblese.



- Mbledhja e Asamblese thirret nga kryetari, me kërkesë të Kryesisë së Dhomës, e cila cakton edhe rendin e ditës. Kur kryetari, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, nuk mbledh Asamblenë, atëherë Kryesia ka të drejtë ta mbledhë vetë Asamblenë, duke lajmëruar për datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Dergimi i materialeve dhe njoftimi për datën dhe vendin e mbledhjes behet te pakten nje jave para dites kur do te zhvillohet mbledhja. Ky njoftim, perfshire edhe materialet e mbledhjes, duhet te kryhet dhe ne forme elektronike, ne internet, ne faqen zyrtare te Dhomes.
- Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
- Asambleja e zakonshme thirret te pakten dy here ne vit. Njera mbledhje duhet te zhvillohet brenda muajit Tetor, per miratimin e projekt-buxhetit dhe programit te vitit te ardhshem. Mbledhja tjeter duhet te zhvillohet brenda muajit Mars, per analizen e veprimtarise se Dhomes gjate vitit te meparshem dhe per miratimin e bilancit te mbyllur te atij viti.
- Asambleja e jashtëzakonshme mblidhet me kërkesë të Kryetarit dhe/ose Kryesisë, ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të saj. Rendi i ditës i asamblesë së jashtëzakonshme caktohet nga kërkuesi.
- Kur Kryetari, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës nga subjektet e përcaktuara në paragrafin më lart, nuk e mbledh Asamblenë, atëherë kërkuesi ka të drejtë ta mbledhë vetë atë, duke njoftuar datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- Votimi për ceshtje behet ne menyre te hapur, ndersa votimi per persona behet gjithnje i fshehte. Ne votimin e hapur, Kryetari kerkon votimin me ngritje dore nga secili antar.
- Kryetari, kur e quan te arsyeshme, ka te drejte te ftoje ne mbledhjet e Asamblese personalitete dhe eksperte te botes ekonomike, si dhe perfaqesues te Bashkimit te Dhomave. Te ftuarit kane te drejte te shprehin mendimet e tyre, por nuk kane te drejte vote.
- Te gjitha diskutimet dhe votimet e mbledhjes se Asamblese shenohen ne një procesverbal, i cili mbahet nga Sekretari i Dhomës dhe nenshkruhet edhe nga Kryetari.
- Vendimet e Asamblese shpallen publikisht ne gazeten e Dhomes, ne faqen zyrtare ne internet. Ato u dergohen zyrtarisht antareve te Asamblese, jo me vone se 10 dite kalendarike nga data e marrjes se vendimeve.
- Asambleja mund te krijojë komisione të vecanta, të perbera nga vete anetarët e Asamblese, me qellim trajtimin e ceshtjeve me rendesi per aktivitetin e Dhomes. Keto Komisione kane nje rol rekomandues dhe propozues, te cilat mund te jene te perhershme, gjate gjithe mandatit te Asamblese, ose te perkohshme.



### **Neni 13**

#### **Afati dhe Shperndarja e Asamblese**

- Mandati i Asamblese zgjat 4 (kater) vjet. Zgjedhjet e reja duhet te zhvillohen brenda 45 diteve nga data e mbarimit te mandatit te Asamblese aktuale.
- Asamblea, ne nje mbledhje te vecante, sipas propozimeve te Kryesise, miraton procedurat e zgjedhjeve dhe rregullat e perfaqesimit ne organet drejtuese, duke respektuar parimin e perpjestimit ne raport me numrin e pergjithshem te antareve te Dhomes.
- Zgjedhjet e reja per Asamblene, Kryesine dhe Kryetarin e Dhomes organizohen dhe drejtohen nga Sekretari i Dhomes.

### **Neni 14**

#### **Kryesia**

Kryesia e Dhomës përbëhet nga Kryetari i Dhomes dhe nga 10 anëtarë, te zgjedhur nga Asamblea e Dhomes. Ne Kryesi sigurohet perfaqesimi i te tre grupeve te biznesit (tregti, industri, sherbime). Kryesia ka nje mandat per nje periudhe 4-vjeçare, qe perputhet me mandatin e Asamblese. Humbja e mandatit si anetar i Asamblese sjell automatikisht humbjen e mandatit si anetar i Kryesise. Anëtarët e kryesisë kanë të drejtë rizgjedhjeje.

### **Neni 15**

#### **Kompetencat e Kryesise**

Kryesia eshte organ kolegjal ekzekutiv, qe drejtohet nga Kryetari i Dhomes. Ajo ka keto kompetenca:

- ✓ Miraton programet e punes, qe lidhen me detyrat dhe objektivat e Dhomes.
- ✓ Miraton strukturen organizative te aparatit administrativ te Dhomes, funksionet dhe pagat e punonjesve te katij aparati.
- ✓ Miraton rregulloren e brendshme te aparatit administrativ te Dhomes.
- ✓ Shqyrton programin vjetor financiar dhe buxhetin perpara se t'i paraqitet Asamblese per miratim.
- ✓ Cakton shperblimet per sherbimet qe kryejne ekspertet e jashtem.
- ✓ Cakton rregullat per perdorimin e fondeve dhe administrimin e tyre.
- ✓ Propozon ndryshimet ne statutin e Dhomes.



- ✓ Percakton rendin e dites se mbledhjes se Asamblese se Dhomes.
- ✓ Merr vendime per te gjitha ceshtjet, qe shtrohen per shqyrtim nga Kryetari dhe/ ose Sekretari i Dhomes.
- ✓ Kryen te gjitha funksionet te cilat sipas ligjit apo ketij Statuti nuk jane kompetenca te Asamblese, te Kryetarit, te Sekretarit apo te Administrates se Dhomes.
- ✓ Merr, ne raste urgente, vendime ne kompetence te Asamblese, te cilat duhet te ratifikohen nga mbledhja e zakoneshme apo e jashtzakoneshme e Asamblese.
- ✓ Te ratifikoje vendime ne kompetence te saj, te marra nga Kryetari, ne raste urgente.

Kryesia eshte pergjegjese per:

- zbatimin e vendimeve te Asamblese
- mbarevajtjen e veprimtarise se Dhomes

## **Neni 16**

### **Funksionimi i Kryesise**

- Kryesia, si rregull, mblidhet jo më pak se një herë në muaj, e thirrur nga Kryetari i Dhomës ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve. Njoftimi dhe dergimi i materialeve behet te pakten 7 dite para dates se caktuar per mbledhje.
- Mbledhja e kryesisë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit te anëtarëve. Ne cdo rast nuk pranohet delegimi i votes
- Mbledhja drejtohet nga Kryetari dhe në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të kryesisë, i caktuar nga kjo e fundit.
- Vendimet e kryesisë janë të vlefshme kur për to votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Ne rast barazimi votash vendos vota e Kryetarit.
- Vendimet e kryesisë nënshkruhen nga Kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të saj, i caktuar nga kjo e fundit për të drejtuar mbledhjen.
- Mbledhjet e Kryesise nuk jane publike. Ne to mund te marrin pjese, pa te drejte vote, Sekretari dhe Anetaret e Komisionit te Auditimit (keta te fundit vetem kur diskutohen ceshtje, qe kane te bejne me financat e Dhomes). Gjithashtu ne mbledhje mund te ftohen te marrin pjese dhe nepunes te administrates se Dhomes, prania e te cileve eshte e domosdoshme per ceshtjet qe do te trajtohen.



## **Neni 17**

### **Te drejtat dhe detyrat e antarit te Kryesise**

- Cdo antar i Kryesise ka te drejten e nje vote. Cdo antar i Kryesise duhet te abstenoje nga votimi, duke u larguar nga mbledhja, kur diskutohet dhe vendoset per nje ceshtje, e cila direkt ose indirekt krijon per te pozicion te papajtueshem, per shkak konflikti interesi.
- Cdo antar i Kryesise ka te drejte te marre nga Sekretari i Dhomes kopje te vendimeve si dhe informacione te dobishme per realizimin e detyres se tij.
- Anetari i Kryesise, qe nuk merr pjese ne kater mbledhje gjate vitit kalendarik, humbet te drejten per te qene anetar i Kryesise ne vazhdim te mandatit te saj. Anetari zevendesues zgjidhet nga Asamblea.
- Per shkelje te renda te ligjit, te Statutit, te vendimeve te Asamblese, mund te paraqitet mocion mosbesimi per antaret e Kryesise dhe Kryetarin. Mocioni i mosbesimit duhet te nenshkruhet nga jo me pak se nje e treta e Asamblese dhe te votohet ne nje mbledhje te jashtzakoneshme nga jo me pak se dy te tretat e antareve te saj. Ne rastin e miratimit te mocionit p̄der antaret e Kryesise, Kryetari Dhomes organizon dhe drejton mbledhjen e Asamblese per zgjedhjen e antareve te tjere te rinj te Kryesise. Ne rastin e miratimit te mocionit per Kryetarin, mbledhja e Asamblese per zgjedhjen e Kryetarit te ri organizohet nga Sekretari i Dhomes.

## **Neni 18**

### **Kryetari i Dhomes**

- Kryetari i Dhomes zgjidhet me votim te fshehte nga Asamblea, per nje periudhe katervjecare. Kryetari zgjidhet midis antareve te Asamblese, brenda 10 ditesh nga formimi i Asamblese.
- Kryetar i Dhomes mund t̄e zgjidhet çdo shtetas shqiptar, q̄e ka zot̄esi t̄e plot̄e p̄r t̄e vepruar, ka mbaruar arsimin e lart̄e, si dhe ka treguar aftesi te dukshme ne fushen e biznesit, ne fushat akademike apo ne administrim.
- Kryetari i Dhomes, pas perfundimit te mandatit, gezon te drejten te jete anetar i Asamblese se ardhshme, pa iu nenshtruar procedurave te zgjedhjes.



- Kryetari drejton veprimtarine e Dhomes dhe Kryesine e saj. Ai eshte perfaqesues ligjor i Dhomes ne marredhenie me te tretet, si dhe pergjigjet per aktivitetin, administrimin dhe funksionim e Dhomes.
- Ne raste urgjence, Kryetari ka te drejte te marre vendime ne kompetence te Kryesise, te cilat duhet te ratifikohen ne mbledhjen e saj te radhes.
- Kryetari ka te drejten e emerimit te punonjesve te Dhomes, sipas struktures se miratuar nga Kryesia.
- Kryetari eshte funksionar dhe paguhet nga Dhoma.

## **Neni 19**

### **Sekretari i Dhomes**

Sekretari i Dhomes emërohet dhe shkarkohet me urdhër të Ministrit. Ne rastin e shkarkimit duhet te merret edhe mendimi i organeve drejtuese te Dhomes

Sekretari i Dhomes duhet të jetë shtetas shqiptar, me arsim të lartë dhe të mos ketë qenë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra penale.

Sekretari i Dhomes është funksionar me kohë të plotë dhe paguhet nga Dhoma.

Sekretari i Dhomës ka këto kompetenca:

- ✓ Njofton periodikisht organin mbikëqyrës për veprimtarinë e Dhomës.
- ✓ Ndjek respektimin nga Dhoma të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi.
- ✓ Ndjek zbatimin e vendimeve të Kryesisë dhe të Asamblesë së Dhomës.
- ✓ Ndjek procedurat e regjistrimit të anëtarësisë se subjekteve tregtare ne Dhome.
- ✓ Ushtron çdo kompetencë tjetër, të parashikuar me ligj.
- ✓ Në rastet kur vëren shkelje të ligjshmërisë në vendimet e marra nga organet e Dhomës, njofton organin mbikëqyrës, i cili, brenda 30 ditëve nga vënia në dijeni, u kërkon këtyre organeve rishikimin e vendimeve të marra.

## **Neni 20**

### **Komisioni i Auditimit**

- Komisioni i auditimit zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare dhe përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët njëri është ekspert kontabël i autorizuar dhe emërohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, ndërsa dy të tjerët zgjidhen nga Asambleja e Dhomës, njëri me profesion jurist dhe tjetri me profesion ekonomist. Ne mbledhjen e tij te pare Komisioni zgjedh kryetarin e tij. Ne rastin kur nje nga anetaret e zgjedhur te Komisionit nuk mund te ushtroje detyren, Kryetari i Dhomes fillon procedurat per zgjedhjen e anetarit te ri nga Asambleja.



- Per kryerjen e aktivitetit të tij, Komisioni bashkepunon me administratën e Dhomes. Per kete qellim Komisionit i vihet ne dispozicion cdo akt dhe dokument administrativ dhe financiar i Dhomes. Komisioni i auditimit ka për detyrë të kontrollojë veprimtarinë ekonomiko-financiare të Dhomës dhe të raportojë në mbledhjen vjetore të asamblesë për administrimin e mjeteve dhe të burimeve financiare të Dhomës.
- Raportet e Komisionit miratohen dhe firmosen nga te pakten dy prej anetareve te tij. Pas miratimit në Asamble, raporti i Komisionit të Auditimit i dërgohet për njoftim organit mbikëqyrës.
- Komisioni i Auditimit ka te drejte te beje ne cdo moment akte kontrolli apo inspektime dhe ne rast se konstaton shkelje, njofton menjehere Kryetarin e Dhomes.
- Me kërkesë të Kryetarit, të Asamblesë dhe të Sekretarit të Dhomës, komisioni mund të ushtrojë kontroll tematik.

### **KREU III. ANTARSIA E DHOMES**

#### **Neni 21**

##### **Antarsimi ne Dhome**

- Anëtarësia në Dhomë është e detyrueshme për ndërmarrjet shtetërore, si dhe për personat juridikë, të regjistruar në regjistrin tregtar dhe është vullnetare për personat fizikë, që kanë cilësinë e tregtarit, të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare, industriale.
- Antaresimi ne Dhome mbeshtetet nga Organet Tatimore (Zyra e Taksave, Bashkite, Komunat), te cilat gjatë veprimtarisë së tyre kontrolluese, detyrojnë subjektet tatimore që të jenë anëtare të Dhomës.

#### **Neni 22**

##### **Regjistri i Dhomes**

Dhoma mban regjistrin e anëtarësisë. Forma e këtij regjistri dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen nga Asamblea e Bashkimit të Dhomave. Të dhënat e regjistrit duhet të jenë në formë të shkruar dhe elektronike dhe ruhen sipas rregullave të përcaktuara në *Manualin* e Dhomes. Regjistri i Dhomes është publik



## Neni 23

### Kuota vjetore e anetaresimit

- Anëtarët e Dhomës paguajnë kuotën vjetore të anëtarësisë, e cila aplikohet për një vit kalendarik, me shtrirje nga data 1 Janar deri me 31 Dhjetor. Antaret e rinj, të cilët rregjistrohen gjatë vitit paguajnë në përputhje me periudhën e mbetur.
- Si kriter për caktimin e vlerës së kuotës vjetore për bizneset egzistuese merret xhiro vjetore e vitit të mëparshëm, ndërsa për antaret e rinj merret parashikimi zyrtar për xhiron vjetore. Për një caktim të arsyeshëm të kuotave, bizneset ndahen në kategori sipas xhiros vjetore të realizuar, duke ngarkuar me tepër antaret me xhiro vjetore më të lartë. Kategoritë e biznesit dhe kuota perkatese percaktohen me vendim të Asamblesë, i cili duhet të miratohet nga Ministria.

## KREU IV. ORGANIZIMI I DHOMES

### Neni 24

#### Strukturat

Veprimtaria e Dhomes është produkt i operimit të saj, të ndarë në dy struktura: *vertikale* dhe *horizontale*.

#### **a) Struktura vertikale**

Organi vendim-marrës më i lartë i Dhomes është Asambleja, kompetencat dhe menyrat e funksionimit të së cilës percaktohen nga nenet 9, 10, 11, 12, 13 të këtij Statuti.

Organi i dytë në hierarkinë vendim-marrëse është Kryesia, kompetencat dhe menyrat e funksionimit të së cilës percaktohen në nenet 14, 15, 16, 17 të këtij Statuti

#### **b) Struktura horizontale**

Organi ekzekutiv më i lartë i Dhomes është Kryetari, kompetencat e të cilit percaktohen në nenin 18 të këtij Statuti.

Organe ekzekutive të Dhomes janë Sekretari dhe Komisioni i Auditimit, kompetencat e të cilëve percaktohen perkatesisht në nenet 19 dhe 20 të këtij Statuti.

Për zbatimin e organeve vendim-marrëse dhe për realizimin e shërbimeve të Dhomes, krijohen njësi organizative ekzekutive të administratës së Dhomes, si:

*Kabineti i Kryetarit*

*Departamentet, me të pakten 5 punonjës, që drejtohen nga një drejtor*



*Zyrat*, me te pakten 3 punonjes, qe drejtohen nga nje pergjegjes

Deri ne plotesimin me personel per ngritjen e Departamenteve apo te Zyrave, administrata e Dhomes mund te funksionojë me inspektore pergjegjes, me detyra te kontratuara, qe mbulojne te gjitha fushat e veprimtarise se saj.

Dhoma mund te kontratoje eksperte te jashtem, per ceshtje specifike, qe kerkojne trajtim profesional. Kryetari i Dhomes, ne kabinetin e tij mund te mbaje keshilltare te jashtem me profil ekonomik apo juridik. Shperblimet per ekspertet dhe keshilltaret e jashtem percaktohen nga Kryesia.

## **KREU V. ADMINISTRIMI FINANCIAR**

### **Neni 25**

#### **Parime te pergjitheshme**

Per pasqyrimin e veprimeve financiare te Dhomes dhe mbajtjen e llogarive zbatohen kerkesat e ligjit nr.7661 date 19.01.1993, "Per Kontabilitetin", si dhe ligji vjetor per Paketën Fiskale. Per detajimin e te gjitha veprimeve financiare dhe te dokumentimit te tyre hartohet nje rregullore, e cila perfshihet ne *Manualin e Dhomes*.

### **Neni 26**

#### **Burimet financiare te Dhomes**

Të ardhurat e Dhomës realizohen nëpërmjet:

1. Kuotizacionit vjetor të anëtarëve të Dhomës.
2. Shërbimeve nga veprimtaria e Dhomës, tarifât e te cilave percaktohen nga Kryesia
3. Kontributeve të donatorëve, vendas dhe të huaj.
4. Te hyrat nga projektet me partnere vendas apo te huaj
5. Burimeve te tjera, të cilat nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per organizatat jofitimprurese.



## **Neni 27**

### **Disponimi i pasurive te paluajtshme**

Dhoma e Tregtise dhe Industrise Qarku Durres mund te fitoje ne pronesi dhe te administroje pasuri te paluajtshme, ne perputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi, per organizatat jofitim pruese.

## **KREU VI. DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 28**

#### **Ndryshimi i Statutit**

Dispozitat e ketij Statuti mund te ndryshohen me votat e shumices absolute te numrit te pergjithshem te anetareve te Asamblese. Cdo ndryshim i Statutit i njoftohet organit mbikqyres, per t'u shprehur per ligjshmerine e tij.

### **Neni 29**

#### **Plotesimi**

Per cdo argument, qe nuk eshte trajtuar shprehimisht ne kete Statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9640, date 9.11.2006, "Per Dhomat e Tregtise dhe Industrise", aktet nenligjore te ketij ligji, si dhe te gjitha ligjet ne fuqi, qe kane lidhje me veprimtarine e Dhomes.

### **Neni 30**

#### **Hyrja ne fuqi e Statutit**

Ky Statut miratohet me vendim te Asamblese se Dhomes se Tregtise dhe Industrise Qarku Durres, me date 10 Mars 2007.

Statuti hyn ne fuqi menjehere pas miratimit nga Ministri pergjegjes per tregtine.